AKT-THEMELIMI

I

SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

" ELKRI " SH.P.K.

ORTAKET

1.Fotina Rondo,e bije e Lefterit,e datelindjes 1958,lindur ne Himare dhe banuese ne lagjen nr. 4 te qytetit te Sarandes.
Ortaku i vetem me vullnetin e tij te plote dhe te pavesuar ka themeluar Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar " ELKRI " SH.P.K.

QELLIMI

NENI 1

Qellimi i ketij akti themelimi eshte krijimi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar " ELKRI " SH.P.K. e cila e ka qendren ne lagjen nr. 4 te qytetit te Sarandes.
Objekti i veprimtarise se kesaj shoqerie percaktohet ne statuttin e kesaj shoqerie qe i bashkelidhet ketij akti dhe eshte :Studimi dhe projektimi i objekteve civile e industriale,riparimi dhe ndertimi i objekteve civile e industriale,prodhimi dhe tregetimi i materialeve te ndertimit,transportin e mallrave dhe te udhetareve,importin dhe eksportin e pergjithshem.

DATA EFEKTIVE

NENI 2

Kjo kontrate do te jete efektive qe nga momenti qe do te nenshkruhet nga ortaku statuti,kerkesa,te jete plotesuar e gjithe procedura ligjore,te jete bere regjistrimi ne gjykaten e rrethit Tirane,te jete fituar zotesia juridike per te vepruar si person juridik.

AFATI

NENI 3

Shoqeria " ELKRI " SH.P.K. do te jete me kohezgjatje 35 (tridhjete e pese) vjet.Mbarimi i kesaj shoqerie do te percaktohet ne statut.

KAPITALI

NENI 4

Kapitali i kesaj shoqerie eshte 100.000 (njeqind mije) leke.Ky kapital eshte i depozituar ne Banken e Kursimeve Sarande.Kapitali eshte vendosur 100% nga Fotina Rondo dhe eshte i ndare ne 100 aksione me vlere 1.000 leke sejcili.

JURIDIKSIONI

NENI 5

Shoqeria " ELKRI " SH.P.K. e zhvillon veprimtarine e saj ne baze te aktit te themelimit,statutit si dhe legjislacionit shqiptar,ligjit 7638 date 19.11.1992 " Per Shoqerite Tregetare " me ndryshimet e tij. Ky akt themelimi pasi lexohet dhe gjendet ne perputhje me vullnetin e ortakut nenshkruhet prej tij.

O R T A K U
Fotina Rondo

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA Sarande

Nr. 880 rep.

Ne Sarande sot me daten 27.4.1998 (prill njemije e nenteqind e nentedhjete e tete) para meje noterit u paraqit personalisht Fotina Lefter Rondo,e datelindjes 1958,banuese ne lagjen nr.4 te qytetit te Sarandes,madhore,me zotesi te plote juridike,me identitet te njohur sipas ligjes,e cila nenshkruan kete akt para meje noterit.

NOTERI
Musa Cerbri

S T A T U T I

I

SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

" ELKRI " SH.P.K.

U [illegible] si me poshte :

Fotina Lefter Rondo,e datelindjes 1958,lindur ne Himare dhe banuese ne lagjen nr. 4 te qytetit te Sarandes,e cila kerkoi te redaktohet ky akt me te cilin deklaroi dhe ra dakord si me poshte :

Te krijoj Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar " ELKRI " SH.P.K. ne perputhje me kushtet e parashikuara me poshte,te cilat i pranon me mirkuptim te plote dhe harton kete statut.

KAPITULLI I

KRIJIMI,QELLIMI,EMERI,KOHEZGJATJA.

KRIJIMI

NENI 1

Mbeshtetur ne kete statut krijohet Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar " ELKRI " SH.P.K.Ne mardheniet me jashte kjo shoqeri do te njihet me emrin " ELKRI " L.t.d.

QELLIMI

NENI 2

Qellimi i shoqerise " ELKRI " percaktohet nga veprimtaria qe ajo do te zhvilloje dhe me konkretisht :

1.Studimin dhe projektimin e objekteve civile e industriale.
2.Riparimin dhe ndertimin e objekteve civile e industriale.
3.Prodhimin dhe tregetimin e materialeve te ndertimit.
4.Transportin e mallrave dhe te udhetareve.
5.Importin dhe eksportin e pergjithshem.

Organi drejtues i shoqerise vendos per çdo ndryshim ne veprimtarine e saj.

SELIA

NENI 3

Selia e shoqerise do te jete ne lagjen nr. 4 te qytetit te Sarandes. Kjo mund te ndryshohet ne interes te realizimit te veprimtarise se shoqerise.Shoqeria mund te krijoje dege te saj edhe ne qytete te tjere brenda dhe jashte vendit.

NOTERI SARANDE

EMERTIMI

NENI 4

Emeri i shoqerise do te jete :Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar " ELKRI " SH.P.K.Ne mardheniet me jashte kjo shoqeri do te njihet me emerin " ELKRI " L.t.d.

KOHEZGJATJA

NENI 5

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj te ligjshem brenda nje harku kohor prej 35 (tridhjete e pese) vjet.Ky afat fillon te ece me regjistrimin e shoqerise ne organet kompetente dhe çdo ndryshim i tij mund te behet vetem me vendim te organit drejtues te shoqerise ose me çdo shkak tjeter te percaktuar ne ligj.

KAPITULLI II

KAPITALI I SHOQERISE

NENI 6

Kapitali fillestar i shoqerise eshte shuma ne para ne masen 100.000 (njeqind mije) leke,shume kjo e ndare ne 100 aksione me vlere te barabarte prej 1.000 (njemije) leke sejcili.Ky kapital ndodhet i depozituar prane Deges se Bankes se Kursimeve Vlore,ne llogarine perkatese te shoqerise.Kapitali eshte vendosur 100% nga ortaku i vetem,Potina Rondo se ciles i perket dhe e gjithe kuota e aksioneve te shoqerise prej 1 e deri ne 100.

Kapitali eshte lirisht i transferueshem midis ortakeve te shoqerise. Sejcili prej ortakeve gezon te drejten e parablerjes se pjeses se kapitalit te ortakeve te tjere ne rast te transferimit te kapitalit ne persona te trete.

KAPITULLI III

ORGANIZIMI,FUNKSIONIMI DHE DREJTIMI I SHOQERISE

NENI 7

MBLEDHJA E ASAMBLESE

Organi me i larte drejtues i shoqerise eshte Asambleja e ortakeve,organ i cili ka tedrejte te vendose per te gjithe çeshtjet qe lidhen me aktivitetin e shoqerise.Vendimet e Asamblese jane te detyrueshme per te gjithe ortaket e shoqerise,pavaresisht nga menyra e votimit per to. Asambleja mblidhet ne mbledhje te zakoneshme te saj te pakten 1 here ne 6 muaj.Ajo thirret nga administratori,apo dhe me nismen e çdo ortaku.Vendimet e saj Asambleja i merr me shumicen e votave te pjeseve te kapitalit.Per probleme te rendesise se veçante Asambleja thirret ne mbledhje te jashtezakoneshme me rend dite te percaktuar qe me pare.

E DREJTA E VOTES

NENI 8

Cdo ortak merr pjese ne Asamblene e ortakeve si element i vetem dhe numur te tille votash sa dhe pjeset e kapitalit qe ai zoteron ne kapitalin e shoqerise.Numuri i votave eshte i barabarte me numurin e aksioneve qe zoteron çdo ortak.

MARRJA E VENDIMEVE

NENI 9

Vendimet e saj Asambleja i merr me shumicen e thjeshte te votave qe perfaqesojne shumicen e thjeshte te pjeseve te kapitalit te shoqerise.Per vendime te rendesishme Asambleja vendos me 3/4 e pjeseve te kapitalit dhe konkretisht lidhur me keto probleme :

1.Ndryshimet ne statut.
2.Pranimi i ortakeve terinj.
3.Rritja ose pakesimi i kapitalit te shoqerise.
4.Venia ne likujdim e shoqerise.

ADMINISTRIMI I SHOQERISE

NENI 10

Shoqeria administrohet dhe perfaqesohet ne marrdheniet me te tjere nga administratori.Administratori i saj eshte Fotina Rondo.
Administratori zgjidhet dhe shkarkohet me shumicen e thjeshte te votave nga ana e Asamblese.Atij i njihet e drejta e doreheqies por me kusht qe do te ushtroje detyrat e tij baze ketij statuti deri ne zgjedhjen e pasardhesit te tij ne mbledhjen me te afert te Asamblese se ortakeve.

KAPITULLI IV

TE DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKEVE

NENI 11

Cdo ortak ka te drejte te marre pjese ne drejtimin e shoqerise.Pjesmarja e tij kushtezohet nga pjesa e kapitalit ne kapitalin e shoqerise.Ne varesi te tij ndahet dhe fitimi ,por perballohen dhe humbjet e rezultuara gjate veprimtarise se shoqerise.Cdo ortak ka te drejte te transferoje lirisht pjeset e tij te kapitalit ne trashegimtaret e tij,ne ortaket e tjere apo ne persona te trete,me kusht qe ai duhet te respektoje te drejten e parablerjes nga ortaket e tjere.Cdo ortak ka te drejte te largohet nga shoqeria ne menyre te njezneshme,por me pare ai detyrohet qe te njoftoje per kete largim jo me pak se 1 muaj me pare.Shkelja e ketij detyrimi e ngarkon ate me shperblimin e demeve te ardhura shoqerise per kete shkak.

NDARJA E FITIMEVE DHE E HUMJEVE

NENI 12

Gjithe fitimi qe rezulton nga aktiviteti i shoqerise ndahet midis ortakeve te shoqerise ne perpjestim me pjesen e kapitalit qe ai zoteron ne shoqeri.Po mbi keto kritere do te perballen dhe humbjet e pesuara gjate ketij aktiviteti.

SHPERNDARJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

NENI 13

Shoqeria mund te shperndahet :1.Me vendim te Asamblese se ortakeve me 3/4 e votave te tyre.2.Me shpalljen e shoqerise ne gjendje varferie,3.Ne rastet e parashikuara nga ligji.

LIKUJDIMI

NENI 14

Ne fazen e likujdimit shoqeria eshte ne funksionim dhe kryen aktivitetet me te domosdoshme lidhur me likujdimin e saj.Ne kete rast mbah te njejtin emer duke shtuar fjalet " ne likjudim ".Likujdimi kryhet nga administratori i shoqerise ose person tjeter i caktuar nga Asambleja.

PERFUNDIMI I LIKUJDIMIT

NENI 15

Pas perfundimit te likujdimit hartohet bilanci perfundimtar i shoqerise ndahet produkti i likujdimit te pasurise se saj tek ortaket ne perpjestim me pjeset e kapitalit qe ata zoterojne.

KAPITULLI VI

DISPOZITA TE FUNDIT

NENI 16

Gjithe mosmarreveshjet e lindura midis ortakeve gjate veprimtarise se shoqerise zgjidhen ne baze te ketij statuti te shoqerise dhe ligjit " Per Shoqerite Tregetare ".Ne rast te mos arritjes se pajtimit midis tyre kompetente per zgjidhjen e ketyre mosmarreveshjeve eshte Gjykata e Rrethit Sarande.

Ky statut u lexua dhe u nenshkrua nga ortaku.

O R T A K U

Fotina Rondo